Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 2 gusht 2013

Lënda nr. 27/09

Vlladimir MANOHIN

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 2 gusht 2013,
me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Z. Marek NOWICKI, kryesues
Znj. Christine CHINKIN
Znj. Françoise TULKENS

Të ndihmuar nga

Z. Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, paraqet gjetjet dhe rekomandimet si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 27 janar 2009 dhe është regjistruar më 2 shkurt 2009.

2. Më 15 qershor 2009, 9 shkurt 2011 dhe 17 prill 2012, Paneli kërkoi nga ankuesi që t'i dorëzojë informatat shtesë. Më 6 qershor 2012, Paneli pranoi informatat shtesë nga ankuesi.

3. Më 5 shtator 2012, Paneli për ankesën e njoftoi Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP)[1], lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e ankesës. Më 15 tetor 2012, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

[1]Një listë me shkurtesa dhe akronime që përmban teksti mund të gjendet në Shtojcën e bashkëngjitur.

4. Më 6 dhjetor 2012, Paneli e shpalli ankesën pjesërisht të pranueshme.

5. Më 10 dhjetor 2012, Paneli ia përcolli vendimin e vet mbi pranueshmërinë PSSP-së, duke kërkuar komentet e UNMIK-ut mbi bazueshmërinë e ankesës. Më 15 janar 2013, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

6. Më 19 qershor 2013, Paneli kërkoi informata shtesë nga ankuesi. Më 16 korrik 2013, Paneli pranoi informata shtesë nga ankuesi.

II. FAKTET

7. Faktet, duke pasur parasysh rëndësinë e tyre në këtë fazë të parashtresave, mund të përmblidhen si më poshtë. Për një përshkrim më të detajuar të fakteve, Paneli i referohet vendimit të vet të 6 dhjetorit 2012 mbi pranueshmërinë e ankesës, §§ 4-14.

8. Ankuesi është ish-banor i Kosovës, i cili tani jeton në Serbi.

9. Ankuesi pohon se ai ka qenë pronar i një banese në Prishtinë. Ankuesi deklaron që ai dhe gruaja e tij jetonin në pronën e lartpërmendur deri në vitin 1999, kur ata u detyruan ta lënë atë për arsye sigurie. Ai deklaron se ai i lejoi fqinjit të tij, z. H.F., që ta marrë me qira pronën e tij, bazuar në një marrëveshje gojore që ata earritënderisa prona u ble nga z. H.F. Megjithatë, pas negociatave që zgjatën disa vjet, kontrata e shitjes nuk u nënshkrua dhe, më 28 tetor 2004 ankuesi e paraqiti një padi në Gjykatën Komunale të Prishtinës kundër uzurpuesit të pretenduar të pronës së tij, z. H.F., duke kërkuar dëbimin e tij dhe kompensimin për qiranë e papaguar.

10. Në kohën në mes të dorëzimit të padisë së ankuesit në vitin 2004 dhe orarit të caktuar për shqyrtim të rastit në vitin 2006 nga Gjykata Komunale e Prishtinës, një person tjetër, z. A.K., erdhi që ta zë pronën. Ankuesi e ndryshoi padinë për ta përfshirë në të z. A.K.

11. Më 5 prill 2006, Gjykata Komunale e Prishtinës caktoi një seancë për rastin e ankuesit. Megjithatë, ankuesi me sa duket nuk e mori njoftimin deri pas datës së caktuar të seancës dhe kështu ai nuk mori pjesë.

12. Më 14 shtator 2006, Gjykata Komunale e Prishtinës mbajti një seancë tjetër. Në të nuk morën pjesë as ankuesi e as të padituri, megjithëse përfaqësuesi ligjor i ankuesit-i cili ishte i pranishëm-u urdhëroa nga Gjykata që t'i sigurojë asaj adresat e sakta të dy të padituve brenda tridhjetë ditësh.

13. Më 17 tetor 2006, ankuesi u informua përmes një letre nga Organizata Joqeveritare PRAXIS, se pagesat për përfaqësimin e tij ligjor që pranoheshin nga PRAXIS do të ndërpriteshin. PRAXIS e informoi z. Manohin që për shkak të përfundimit të projektit të vet, nuk mundet më t'i paguajë tarifate avokatit të tij. Prandaj, PRAXIS e informoi z. Manohin që ai, ose mund ta paguajë avokatin e tij vetë, ose të tërheqë ankesën. Përfaqësuesi ligjor i ankuesit ndërpreu përfaqësimin e tij lidhur me ankesën në atë kohë. Nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi kishte zënë përfaqësues tjetër ligjor në atë fazë.

14. Më 13 prill 2007, Gjykata Komunale e Prishtinës mori vendim të hedhë poshtë padinë e ankuesit për pronën si jo të plotë, për shkak se nuk i ishte ofruar Gjykatës adresat e sakta të të padituve, siç ishte urdhëruar më 14 shtator 2006. Ankuesi gjithashtu deklaron që ai

nuk mori një kopje të urdhrit të lartpërmendur apo të vendimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës të 13 prillit 2007.

15. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me drejtësinë në Kosovë përfundoi me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pasi që kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), nxori Deklaratën që mirëpriste angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

16. Më 26 prill 2012, ushtruesja e detyrës së kryetarit të Gjykatës Komunale të Prishtinës, i dërgoi një letër Panelit duke pranuar se ajo nuk kishte gjetur dëshmi se vendimi i saj, i 13 prillit 2007, i ishte dorëzuar ndonjëherë ankuesit apo përfaqësuesit të tij ligjor. Ajo gjithashtu theksoi që ndjehej keq për ankuesin dhe se mjetet e mëtejme ligjore janë në dispozicion të tij.

17. Më 12 qershor 2012, Paneli e informoi Gjykatën Komunale të Prishtinës që ankuesi nuk e kishte marrë kurrë vendimin e saj të 13 prillit 2007.

18. Më 8 gusht 2012, ankuesi e përfundoi shitjen e pronës së tij z. H.F.

III. ANKESA

19. Duke pasur në konsideratë shpalljen e ankesës të pranueshme, ankuesi, në esencë, ankohet se Gjykata Komunale e Prishtinës, duke vonuar dorëzimin e vendimit të saj, shkeli të drejtën e tij për një vendim gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme, e garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ-së.

IV. LIGJI

20. Ankuesi pohon që Gjykata Komunale e Prishtinës nuk i dorëzoi atij kurrë vendimin e saj të 13 prillit 2007, i cili e hidhte poshtë padinë e tij për uzurpim duke u bazuar në aspektin procedural. Në këtë drejtim, ai, në esencë, ankohet që Gjykata Komunale e Prishtinës shkeli të drejtën e tij për një vendim brenda një kohe të arsyeshme, e garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ-së.

21. Në përgjigjen e tij, PSSP-ja sjell argumente kundër asaj që UNMIK-u kishte përgjegjësinë për shkeljet e pretenduara të së drejtës së ankuesit për një vendim brenda një kohe të arsyeshme. PSSP-ja thekson që, "sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut 'arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet në dritë të rrethanave të rastit dhe në lidhje me një numër kriteresh duke përfshirë sjelljen e ankuesve'. Mendohet se z. Manohin ka dështuar të paraqesë dëshmi që tregon se ai me zell ka kërkuar të marrë vesh për progresin në ankesën e tij para Gjykatës Komunale të Prishtinës."

22. PSSP-ja i referohet një letre nga PRAXIS, e 17 tetorit 2006 (shih § 13 më lart), që informoi z. Manohin se tarifate tij ligjore nuk do të paguheshin më dhe se atij do t'i kërkohej që të paguajë për ndonjë përfaqësim të mëtejmë ligjor, apo ta tërheqë ankesën e tij. PSSP-ja thekson që kjo letër, "është dashur ta nxisë ankuesin që t'i ndjekë seancat para Gjykatës Komunale vetë apo në një mënyrë më proaktive". PSSP-ja argumenton që asgjë në dosje nuk tregon se ankuesi ndërmori hapa proaktivë për t'u përpjekur që të rregullojë

situatën e tij pas tetorit të vitit 2006; për shembull, ankuesi ka mundur ta informojë gjyqin se ai nuk përfaqësohej më nga ish-avokati i tij. PSSP-ja deklaron që "duke pasur parasysh heshtjen e të dyve, të ankuesit dhe përfaqësuesit të tij të autorizuar ligjor, nuk është e qartë se si dhe kush është dashur t'ia sjellë Gjykatës Komunale të Prishtinës detajet e sakta të kontaktit për ankuesin, në mënyrë që të jetë në gjendje t'i dorëzojë atij ftesat dhe vendimin e lartpërmendur."

23. Në vendimin e vet mbi pranueshmërinë të 6 dhjetorit 2012, Paneli theksoi që "[n]ga kohëzgjatja e përgjithshme prej më shumë se pesë vjet e dy muaj [në të cilën ankuesi paraqiti ankesë në Gjykatën Komunale të Prishtinës por nuk mori vendim], periudha në mes prillit të vitit 2007 dhe 31 dhjetorit 2008 paraqet përafërsisht një vit e 8 muaj kohë për shqyrtim që bien brenda juridiksionit të Panelit."

24. Paneli thekson se më 19 qershor 2013, ai i kërkoi ankuesit që të sigurojë më shumë informata rreth hapave që ai i ndërmori *vis a vis* padisë së tij para Gjykatës Komunale të Prishtinës, pasi pagesa e përfaqësimit të tij ligjor ishte ndërprerë nga PRAXIS. Në mënyrë specifike, Paneli kërkoi informata për atë nëse ankuesi kishte ndërmarrë hapa proaktivë për rastin e tij para Gjykatës Komunale të Prishtinës. Në atë kohë, ankuesi informoi Panelin që ai nuk kishte marrë ndonjë hap proaktiv pasi që kuptoi se PRAXIS nuk do të paguante më përfaqësimine tij ligjor.

25. Paneli nuk mund të mos theksojë se në një rrethanë të tillë, ku ankuesi e kuptoi se ai po e humbiste përfaqësimin e tij ligjor, ishte së paku pjesërisht përgjegjësi e tij që të informojë Gjykatën Komunale të Prishtinës për atë se kush, nëse dikush, do ta përfaqësonte atë në të ardhmen dhe në çfarë adrese duhej t'i dërgoheshin ftesat dhe vendimet e veta pasuese. Siç kuptohet, Paneli konsideron se dështimi i ankuesit që t'i ofrojë Gjykatës Komunale të Prishtinës informata përkatëse, në fakt i kontribuoi ndjeshëm vonesës në marrjen e vendimit të saj të 13 prill 2007 nga ana e tij.

26. Si pasojë, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht,

– **KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT.**

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues